



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

MBI PJESËMARRJEN E SHQIPËRISË NË SAMITIN E TEKNIKAVE TË ARSIMIT PËR PROJEKTIN “FATÏH”, ANKARA, TURQI

Ministria Kombëtare e Arsimit, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit për Inovacionin organizon Samitin e Teknikave të Arsimit për Projektin “FATÏH”, i cili do të mbahet në datat 2-3 Nëntor 2018 në Ankara të Turqisë.

Samiti do të prezantojë një platformë ku akademikët, hartuesit e politikave, mësuesit, studentët, përfaqësuesit e OJQ-ve dhe ekspertët e teknologjisë në sektorin privat do të takohen dhe do të ndajnë informacione të ndryshme teorike dhe praktike. Në këtë Samit, pjesëmarrësit do të paraqesin prezantimet e tyre lidhur me nevojat e studentëve dhe gjetjet në teknologji dhe inovacion brenda kontekstit të projektit “FATÏH”. Ky takim i përbashkët, i cili do të mbahet në gjuhën turke ose angleze do të mundësojë shkëmbimin e ideve nga shumë ekspertë, të cilët do të monitorojnë nga afër Projektin “FATÏH”.

Lidhur me afatet:

- Dorëzimi i abstrakteve për Projektin “FATÏH”, afati i fundit është data **5 tetor 2018**;
- Njoftimi për miratimin e abstrakteve për Projektin “FATÏH” do të bëhet në datën **15 tetor 2018**;
- Regjistrimi në faqen web për projektin “FATÏH”, afati i fundit është data **1 nëntor 2018**;
- Dorëzimit i dokumenteve të plota për projektin “FATÏH”, afati i fundit është data **15 nëntor 2018**.

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe kushteve që duhet të plotësojë kandidati, ju lutemi referojuni adresave të mëposhtme në web:

<http://fatihprojiesietz.meb.gov.tr>

<http://fatihprojiesietz.meb.gov.tr/homepage-2/>

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS